



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____

Data: _____

Në bazë të dispozitave të nenit 21, neni 25 paragrafi 25.2 pika h) të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht neni 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike Banësore SH.A, në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **09.08.2019**, mori vendim që të rishpall:

KONKURS

Auditor i Brendshëm – Ndërmarrja Publike Banësore SH.A. Prishtinë

Vendi dhe lokacioni i Punës: Prishtinë,

Zyrtarit Kryesor të Auditimit/Nën mbikqyrje të Komitetit të Auditimit

Fushëveprimi

Bartësi i vendit të punës mbikëqyrë dhe koordinon aktivitetet e auditimit, të buxhetit, të hyrave, shpenzimet, prokurimit, depos, stafit dhe aktiviteteve operative që departamentet e NPB-së i realizojnë gjatë aktiviteteve operative në menaxhimin e NPB-së. Vlerëson efektivitetin e punës dhe zbatueshmërinë konform me procedurat dhe rregullat e NPB-së, si dhe ligjet, rregullat dhe standardet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Aplikon sistemin e kontrollit-auditimit të brendshëm të pranueshëm dhe të efektshëm, të vëzhgojë dhe të kritikoj politikat dhe praktikat që kanë të bëjnë me te gjitha proceset brenda institucionit me theks te veçante kontabilitet, procedurat perfshire ato ligjore, administratën dhe ruajtjen e mjeteve dhe të pasurisë së NPB-së;
- Siguron që aktivitetet e NPB-së të jenë në harmoni me Statusin dhe aktet tjera rregullative, ligjore dhe urdhëresat/udhëzimet nga menaxhmenti;
- Të vlerësoj sistemet e kontrollit të brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti i lart se a janë të përshtatshme dhe adekuate për qëllimet e NPB-së;
- Monitoron dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Aksionarëve, Bordit Drejtues dhe Komitetit të Auditimit të NPB-së në linjë me objektivat e Menaxhmentit;
- Kryen kontrollat të brendshme sipas planit të Auditimit të Brendshëm të aprovuar nga Komiteti i Auditimit te NPB-së;

- Diskuton rezultatet e auditimit të kryer me personin përgjegjës të departamentit apo njësisë dhe jep këshilla dhe udhëzime rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes;
- Përpilon raporte të shkruara dhe i'a paraqet Kryeshefit të NPB-së me qëllim të përcjelljes së mëtuqjeshme të tyre tek përgjegjësit e departamenteve apo njësisë të audituara;
- Përgatitë raport mujor, vjetor dhe sipas kërkesës rreth punëve operative të Auditimit të brendshëm të NPB-së;
- Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e ndryshme të veprimtarisë më qëllim të arritjes së një vlerësimi objektiv;
- Analizon praktikat dhe procedrat e kontabilitetit të NPB-së si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas standardeve të kontabilitetit në vend;
- Koordinon punën me pjesë tjera të institucionit dhe komunikon me autoritet e jashtme brenda kompetencave të saj/tij dhe sipas nevojës;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësisë të cekura përformon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Komiteti i Auditimit të NPB-së.

2. Detyrat dhe obligimet tjera shtesë

- Komiteti i Auditimit të NPB-së mund t'a ngarkojë Auditorin e Brendshëm edhe me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së por gjithsesi në pajtueshmëri me përgjegjësitë dhe kompetencat e saj/tij.

3. Raportimet

- Bartësi i vendit të punës i raporton Komitetit të Auditimit.

4. Kualifikimet dhe pervoja

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në lëmitë e Auditimit të Brendshëm, Kontrollës së Brendshme dhe/apo Financave dhe Kontabilitetit;
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm nga institucionet e licencuara në vend ose jashtë tij;

5. Njohurit dhe shkathtësitë profesionale

- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Njohuri e Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme;
- Shkathtësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi organizative në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë;
- Shkathtësi kompjuterikë në programet kompjuterike Windows, Word, Exel dhe Acces;
- Të zhvilloj vazhdimisht njohuritë, aftësitë profesionale në mënyrë që ti siguroj

- NPB-së mjedis aktivite te auditimit efikase dhe eficiente.
- Kurset dhe trajnimet tjera gjatë karrierës profesionale;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme.

6. Informatë për procedurën e konkurrimit

Kandidatët për Auditor të Brendshëm, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin;
 - CV-në;
 - Letër motivimin;
 - Dëshminë mbi kualifikimin profesional;
 - Çertifikatën për Auditor të Brendshëm;
 - Dëshminë mbi përvojën e punës;
 - Të ketë së paku një referencë (te punëdhënësve të fundit);
 - Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj) dhe
 - Kopjen e letërnjoftimit.
- Kohëzgjatja e punës provuese është 1 vjeçare.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Ndërmarrja Publike Banesore – SH.A. në Prishtinë, Rr. “Xhevdet Doda” nr. 32. Prishtinë ose përmes e-mailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ta shënojnë pozitën për të cilën aplikojnë, adresën e saktë dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Për pozitën e shpallur aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara në konkurs.

Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Komiteti i Auditimit i NPB-së e mban të drejtën e formimit të listës së ngushtë me aplikantët.

Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Konkursi është i hapur nga data **13 Gusht 2019 – 02 Shtator 2019 ora 16:00.**

Këshillë juridike: Afati i ankesës 8 ditë.